



# Udhëzime sigurie për ndërmarrjet e jashtme në lokacionin Lampoldshausen



# 222

**Numër emergjence (zjarr, aksident, emergjencë): 222 (24 orë)**

**Numër emergjence nga telefonat e jashtëm (celularë): 06298/28-222**

**Ku ka ndodhur ngjarja? Çfarë lëndimesh ka?**

**Çfarë ka ndodhur? Prisni për pyetje shtesë!**

**Sa persona të lënduar ka?**

## Sjellja në rast alarm zjarri:

**Sinjali për alarm zjarri:** — — — 3 herë ton i vazhdueshëm nga 12 sekonda.

**Vendosuni në një vend të sigurtë.**

**Merrni me vete personat e të cilët kanë nevojë për ndihmë.**

Në rast alarmi ose evakuimi nga ndërtesa, shkoni menjëherë në pikën e grumbullimit të caktuar për ndërtesën. Mos pengoni operacionet e shpëtimit.

Mbani rrugët të lira për shërbimet e emergjencës.



## Sjellja në rast alarm gazi:

**Sinjali për alarm gazi:**  Ton i gjatë për 15 sekonda.

Qëndroni brenda ndërtesës dhe mbyllni dritaret dhe dyert. Nëse ndodheni jashtë, largohuni nga zona e rrezikut, nëse është e mundur në drejtim të kundërt me erën. Kërkoni ndërtesën e mbyllur më të afërt.



## Lajmërimi i përfundimit të alarmit:

Sinjali për përfundimin e alarmit: ————— Ton i vazhdueshëm për 15 sekonda.



## Sjellja në vendin e punës

Jeni të detyruar të respektoni dhe të zbatoni rregulloret e brendshme të kompanisë në lidhje me sigurinë në punë, sigurinë nga zjarri dhe mbrojtjen e mjedisit.

Mbani kartën tuaj të identifikimit të dukshme.

Fotografimi dhe filmimi janë të ndaluara.

Ambientet janë nën mbikëqyrje të

kamerave.

Dritat e kuqe sinjalizojnë një zonë rreziku. Mos hyni në atë zonë. Një dritë e verdhë që pulson sinjalizon një rrezik të afërt. Largohuni nga zona.

Dritat e kuqe të daljet e ndërtesës sinjalizojnë një zonë rreziku. Mos u largoni nga ndërtesa. Një dritë e verdhë që pulson tregon një zonë rreziku afër. Mund të largoheni nga ndërtesa me kujdes.

Në zona të bllokuara nuk duhet të hyhet ose të kalohet me mjete.

Mos kaloni ose mos udhëtoni përmes lëngjeve të derdhura, substancave të ngurta të panjohura, pluhurit ose reve të gazit që dalin.

Pajisjet elektrike, të shuarjes së zjarrit dhe të sigurisë, si dhe mjetet mbrojtëse, nuk duhet të preken, hiqen ose çaktivizohen pa leje.


Duhet të respektohen shpalljet me altoparlant, për shembull për njoftimet e provave.

Urdhrat e Koordinatorit, Qendrës së Sigurisë, Zjarrfikësve të fabrikës ose Sigurisë së fabrikës duhet të ndiqen menjëherë

Respektoni planet e evakuimit dhe shpëtimit që janë të ekspozuara, si dhe njoftimet e rregulloreve për mbrojtjen nga zjarri.

Ndalohet nisja, fluturimi dhe ulja e sistemeve ajrore të pilotuara dhe të pa-pilotuara.

Qendrën e Sigurisë mund ta kontaktoni në +49 6298 28-220.



## Në territorin e fabrikës zbatohen rregullat e qarkullimit rrugor:

Shpejtësia maksimale e lejuar është 30 km/h.

Automjetet e parkuara nuk duhet të bllokojnë qasjen te pajisjet e sigurisë, të pengojnë qarkullimin e trafikut dhe duhet të parkojnë vetëm në vendet e caktuara ose të shënuara për parkim. Zonat e destinuara për veprimet e shuarjes dhe shpëtimit duhet të mbeten gjithmonë të lira. Mbushja e automjeteve elektrike lejohet vetëm në pikat e mbushjes të shënuara zyrtarisht.



## Zona e sigurisë:

Hyrja në mjediset eksperimentale dhe të furnizimit (stendat e testimit, rezervuarët, laboratorët, etj.) nuk lejohet pa autorizim. Duhet të respektohen shenjat përkatëse të sigurisë! Nëse është e nevojshme, duhet të përdoren pajisjet mbrojtëse të kërkuara. Pirja e duhanit është rreptësisht e ndaluar në këtë zonë, përveç në zonat e caktuara për duhanpirje.



Kontejnerët, koshat dhe pajisjet e shënuara në këtë ose në një mënyrë të ngjashme paraqesin rreziqe për shkak të përmbajtjes së tyre. Gjatë përdorimit, duhet të ndiqen masat e përcaktuara në fletën përkatëse të të dhënave të sigurisë ose udhëzimet e punës. Çdo rrjedhje ose rrezik tjetër për mjedisin duhet të raportohet menjëherë në 222.



Për punimet e mëposhtme kërkohet një leje e shkruar paraprakisht:

- Punime me pluhur, nxehësi dhe zjarr
- Punime në kontejnerë, gropa dhe hapësira të ngushta
- Çaktivizimi i pajisjeve të sinjalizimit të rrezikut
- Hapja e tubacioneve
- Punime në zonat me rrezik shpërthimi (Ex-zona)



Në zonat me rrezik shpërthimi, të shënuara si të tilla (trekëndësh i verdhë me shkronjat e zeza „Ex“), nuk duhet të përdoren ose të mbahen pajisje që mund të jenë burim ndezjeje, për shembull çakmakë ose telefona celularë. Punimet që kryhen në zonën e mbrojtjes „Ex“ duhet të realizohen vetëm me mjete pune që përputhen me udhëzimet e mbrojtjes Ex“ („ATEX“).

Deutsches Zentrum für Luft- und Raumfahrt e. V. (DLR) · DLR-Standort Lampoldshausen



# Unterweisungsnachweis



Firma:

Name des Verantwortlichen:

Datum: von bis

Anlass der Unterweisung:


Sprache: Albanisch

## Unterweisungsthemen:


Sicherheitshinweise am Standort DLR LA (siehe Merkblatt „Sicherheitshinweise für Fremdfirmen am Standort Lampoldshausen“)



Notruf



Verhalten im Alarmfall



Verhalten: Gebote und Verbote

Brandschutz



Regelungen aus der StVO

Zutrittsberechtigung / Rauchverbot

Gefahrstoffkennzeichnung

Erlaubnisscheine

Verhalten in EX-Bereichen

Weitere Themen: (Gefahren im Arbeitsbereich, Auswirkungen auf den laufenden Betrieb, Gefahrstoffe usw.)

Me nënshkrimin tim, deklaroj se kam pranuar fletëinformimin ‘Udhëzimet e Sigurisë’ në vendin e punës Lampoldshausen në një gjuhë që e kuptoj plotësisht. Kam kuptuar përmbajtjen e udhëzimit dhe angazhohem të respektoj në mënyrë të plotë rregulloret e DLR.

Emri	Data	Nënshkrimi
1.		
2.		
3.		
4.		

Unterweiser: \_\_\_\_\_  
Name:

\_\_\_\_\_  
Unterschrift: